



Buletini Gusht 2012 <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 110-Gusht 2012 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga punimet në zgjerimin e rrugës Malishevë-Banjë



Përmbajtja

Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit kalon në kompetencë të nivelit qendror	2
Kryetari Kilaj, priti kampionin e trefishtë botëror në kik-boks, Dardan Morina	3
Nga takimi i kryetarit me palët	4
Kampioni i Kik-boksit ndihmon familjen e dëshmorit Ejup Kryeziu	4
Bashkatdhetari Ilir Berisha ndihmon tri familje të dëshmorëve me 1.500 euro	5
Kryetari Kilaj vizitoi shpellën e Panorcit dhe punimet në të	6
U përrua shtëpia e familjes së Sylejman Xhyliqi nga Maralia	7
Kanë filluar punimet për zgjerimin e rrugës Malishevë-Banjë.....	7
Kryetari Kilaj priti në takim lamtumirës Komandantin e KFOR-it Erhard Dreës	8
Edhe një familje e varfër bëhet me shtëpi.....	9
Malisheva edhe sot i del në ndihmë Dragashit.....	10
Nga mbledhja e Komitetit për Komunitete.....	11
Kolegji “Universum”, ndan pesë bursa për studentë të Komunës së Malishevës	11
Nga mbledhja e tetë e kuvendit të Malishevës	12

Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit kalon në kompetencë të nivelit qendror

Malishevë, 8 gusht



Pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit, mes Komunës së Malishevës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme/Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (MPB/AME), prej sot Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (SHZSH), nga niveli komunal, kalon në kompetencë të nivelit qendror përkatësisht të MPB/AME-së.

Memorandumin e mirëkuptimit e nënshkruan sot, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe kryeshefi i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, z.Fadil Kodra, ku të dy palët nënshkruese, kanë rënë dakord për kalimin e kompetencave të pjesëtarëve të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, nga niveli komunal në atë qendror, duke zbatuar ligjin për Zjarrfikje dhe Shpëtim, nr:04/L-049 dhe udhëzimit administrativ nr.21/2012 për transferimin e SHZSH-së në njësitë profesionale të MPB/AME-së.

Pjesëtarët e Njesisë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, sipas ligjit nr.04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim, janë staf Profesional i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe menaxhohen nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, në bashkëpunim dhe koordinim me komunat.

Kryetari Kilaj, priti kampionin e trefishtë botëror në kik-boks, Dardan Morina

Malishevë, 9 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot në zyrën e tij, kik-boksierin Dardan Morina, nga Drenoci i Malishevës, kampion i trefishtë botëror në kategorinë 76 kg, të cilit edhe i ndau mirënjohje, për kontributin e dhënë, në afirmimin e sportit kosovar në botë.

“Unë ju përgëzoj për titujt e fituar në këtë moshë të re, dhe në të njëjtën kohë, për faktin se në çdo prezantim, e bart flamurin dhe shenjat e shtetërore dhe kombëtare, duke treguar nacionalizmin tënd”, tha kryetari Kilaj,

duke e përgëzuar Morinën për sukseset e arritura.

“Pavarësisht se ende kemi probleme në prezantimin e sportistëve tanë në arenën ndërkombëtare, ju dhe sportistët tjerë, edhe pse mbroni ngjyrat e shteteve tjera, megjithatë po e afirmoni Kosovën dhe kombin shqiptar”, tha Kilaj.



“Qëllimi im është të mbroj ngjyrat e shtetit tim dhe shpresoj se shumë shpejt, do ta na mundësohet ta përfaqësojmë Kosovën në garat ndërkombëtare”, tha kampioni i trefishtë botëror në kik-boks, Dardan Morina.

Dardan Morina, është kampion i trefishtë botëror në Kik-Boks, në kategorinë deri në 76 kg dhe mbron ngjyrat e reprezentacionit të Gjermanisë. Ai shpreson që shumë shpejt, ti mundësohet zhvillimi i ndonjë meçi në Kik-Boks, me karakter ndërkombëtar, në Palestrën e Sporteve në Malishevë, e cila i plotëson të gjitha standardet olimpike.

Dardan Morina dhe familja e tij, përveç sportit, njihen edhe si familje atdhetare dhe shumë humanist. Ai sot, ka ndarë 500 euro, për një familje të dëshmorëve, e cila jeton në kushte më të rënda sociale, për të cilën do të vendos shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, në Malishevë.

Nga takimi i kryetarit me palët

Malishevë, 9 gusht

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, gjatë ditës së sotme, ka pritur për dy orë të tëra qytetarët, në zyrën e tij, me të cilët ka ndarë shqetësimet dhe problemet e tyre.

Shumica prej tyre, kishin për hall, çështjen ekonomike dhe sociale, por kishte edhe nga ata që problem paraqitnin papunësinë.

Me këtë rast, kryetari Kilaj, ka premtuar se do të jap maksimumin në zgjidhjen ose zbutjen e brengave që shqetësojnë qytetarët e Komunës së Malishevës.

Kampioni i Kik-boksit ndihmon familjen e dëshmorit Ejup Kryeziu

Malishevë, 9 gusht

Kampioni i trefishtë botërorë në kik boks, në kategorinë 76 kg, Dardan Morina, nga Drenoci, sot ka vizituar dhe ndihmuar familjen e dëshmorit të kombit, Ejup Kryeziu nga Pagarusha, me 500 euro.

Kik boksieri, Dardan Morina, gjatë takimit me kryetarin e Malishevës, z. Isni Kilaj, shprehu gatishmërinë e tij për ta ndihmuar një nga familjet e dëshmorëve në Malishevë, në shenjë solidarizimi, ndërsa Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve, propozoj familjen e dëshmorit Ejup Kryeziu, nga Pagarusha.



“Kjo është vetëm një ndihmë e vogël për këtë familje, që ka dhënë kaq shumë për vendin, por shpresoj që në të ardhmen të kemi më shumë mundësi dhe të ndihmojmë edhe më shumë, si dhe besoj se ka njerëz të vullnetit të mirë dhe t’ju ndihmojnë këtyre familjeve”, tha prindi Dardanit, Milazim Morina.

I vëllai i dëshmorit, Ejup Kryeziu, Ruzhdiu, duke e falënderuar kampionin dhe familjen e tij, tha se: “vetëm një përkëdhelje për një fëmijët e kësaj kategorie, ka kuptimin e përkrahjes sa një bjeshkë, e kur bëhet fjalë edhe për ndihmë materiale, kjo do të thotë shumë për atë familje ose atë fëmijë”.

“Uroj që ju të keni gjithmonë suksese edhe në të ardhmen dhe në emër të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve në Malishevë, ju falënderoj për këtë përkrahje të madhe për këtë familje të dëshmorit”, tha kryetari i degës së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve në Malishevë, z.Sinan Gegaj.



Bashkatdhetari Ilir Berisha ndihmon tri familje të dëshmorëve me 1.500 euro

Malishevë, 13 gusht

Bashkatdhetari Ilir Berisha, nga Bardhi i Malishevës, i cili jeton dhe punon në Berlin të Gjermanisë, ka ndarë 1.500 euro për tri familje të dëshmorëve në komunën e Malishevës.

Këto mjete, sot janë shpërndarë në familjen dëshmorit Ejup Kryeziut nga Pagarushë, e cila është ndihmuar me 1 mijë euro, familja e dëshmorit Rexhep Kastrati nga Maxharra, me 250 euro, dhe ajo e dëshmorit Zymer Krasniqi nga Astrazubi poashtu me 250 euro.



Dorëzimi i këtyre mjeteve është bërë nga nënkryetari i Komunës së Malishevës z. Rexhep Mazreku, bashkëveprimtari i Ilir Berishës, Hasim Mazreku, dhe përfaqësuesi i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve në Malishevë, Avdyl Morina.



Me këtë rast, nënkryetari i Komunës së Malishevës, ka falënderuar bashkatdhetarin Berisha, duke u shprehur se “ veprimet e tilla humanitare, janë për çdo lëvdatë, ngase po ndihmohen familjet e dëshmorëve, të cilët dhanë jetën për lirinë e vendit”.

Kryetari Kilaj vizitoi shpellën e Panorcit dhe punimet në të

Malishevë, 15 gusht

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka vizituar shpellën e Panorcit, dhe punimet që janë duke u kryer në rregullimin e saj.

Rruga që shpije për te shpella tashmë është e rregulluar dhe është shtruar me zhavorr, ndërkohë që edhe hyrja për në shpellë është e mundur.



Dihet që kjo shpellë është e njohur për stallaktike, stalagmite, pllaka të mermerta dhe stoli të tjera.



E nisur para 3 muajve

U përrua shtëpia e familjes së Sylejman Xhyliqi nga Maralia

Malishevë, 16 gusht

Falë kontributit të mërgimtarëve tanë në Gjermani, Komunës së Malishevës dhe kompanisë “Lirimi”, nga Malisheva, por edhe donatorëve të tjerë, sot është bërë përrimi i shtëpisë së familjes tetë anëtarëshe të Sylejman Xhyliqit nga fshati Marali.

Në fjalën e tij, bashkatdhetari Enver Muzliukaj, tha se “sot ndjehemi të lumtur që e jetësua këtë projekt për familjen Xhyliqi, falë kontributit të bashkatdhetarëve që jetojnë në Shtutgard dhe rreth tij, por edhe përkrahjes së kryetarit të Malishevës, z. Isni Kilaj”. Z. Muzliukaj, falënderoj edhe punëkryerësin, i cili në baza vullnetare ka kryer ndërtimin e kësaj



shtëpie, që në këtë rast ishte “Lirimi”, poashtu nga komuna e Malishevës.

Edhe kryetari i Komunës së Malishevës, nuk ka hezituar të shprehë kënaqësinë e tij, me rastin e përrimit të kësaj shtëpie, duke falënderuar përzemërsisht bashkatdhetarët për këtë kontribut mjaft jetik për këtë familje. “Me ndërtimin e kësaj shtëpie, ne kemi një familje më pak, me nevoja për strehim dhe për këtë u jemi shumë falënderues dhe mirënjohës”, kështu u shpreh midis tjerash kryetari Kilaj në adresë të bashkatdhetarëve. Njëkohësisht z. Kilaj, ka falënderuar edhe firmën “Lirimi” dhe pronarin e saj z. Hashim Thaçi, për punën e bërë në ndërtimin e kësaj shtëpie.

Edhe Sylejman Xhyliqi, në emër të tetë anëtarëve të tij, ka falënderuar të gjithë donatorët për këtë gjest human të treguar ndaj tij dhe familjes së tij.

Kanë filluar punimet për zgjerimin e rrugës Malishevë-Banjë

Malishevë, 21 gusht

Tashmë kanë filluar punimet për zgjerimin e rrugës Malishevë-Banjë, e cila nga dy do të bëhet me katër shirita qarkullimi. Për këtë rrugë, e cila është 17 m e gjerë dhe 530 m e gjatë, komuna do të investoj rreth 300 mijë euro.

Sipas projektit, rruga parashihet të ketë trotuare në të dy anët nga 2m, kanalet për ujëra të zeza, dhe atmosferike, si dhe gypat nëntokësor për rrymë elektrike dhe kabllot e telefonisë fikse.

Punimet e këtij projekti do t'i kryej firma "Shkoza", me seli në Prishtinë.



Kryetari Kilaj priti në takim lamtumirës Komandantin e KFOR-it Erhard Drews

Malishevë, 23 gusht

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur sot në takim lamtumirës, Gjeneralin e KFOR-it Erhard Drews, i cili ishte i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të tij.

Fillimisht është mbajtur një takim në zyrën e kryetarit të komunës, ku është folur për situatën e përgjithshme në komunë dhe Kosovë, ndërsa më pastaj është mbajtur një konferencë për medie.

Kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, e ka falënderuar gjeneralin DREWS, për këtë vizitë, duke i prezantuar më pas një pasqyrë të përgjithshme për komunën që ai udhëheq.



Gjatë konferencës, gjenerali tha se "prej të gjitha vizitave nëpër komunat e Kosovës, mësova se Kosova është një shumëllojshmëri në vete, dhe secila komunë i ka karakteristikat dhe specifikat e veta. Të gjitha komunat i kanë problemet e ngjashme, siç janë papunësia, sfidat e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik apo në infrastrukturë. Por, përveç këtyre problemeve në fillim të misionit tim u ballafaqova edhe me



komunat që kanë probleme specifike. Ndërsa nga raportet e rregullta të LMT-së kam qenë i njoftuar se Malisheva nuk ka probleme specifike, përveç atyre të rëndomta. Kjo edhe ishte arsyeja që e lash të fundit për ta vizituar”.

Gjenerali është pyetur edhe për gjendjen në veri të Kosovës, me ç’rast ai tha se “sa i përket angazhimit të KFOR-it në veri, duhet të merren parasysh dy gjëra. Në radhë të parë ne nuk i kemi ekspertët, mjetet apo edhe nuk e kemi detyrën ta zbatojmë ligjin në pjesën veriore, t’i ndjekim kriminelët. Është thjeshtë mandati ynë që na e kufizon këtë punë. Dhe e dyta sa i përket barrikadave, në vjeshtë të vitit të kaluar kemi filluar në veri me afro 20 barrikada dhe përveç njëres të gjitha të tjerat janë larguar. Ne ballafaqohemi çdo ditë me kërkesa që të



largohet barrikada në urën kryesore të Mitrovicës, kjo barrikadë, e cila është më tepër simbol politik që gjendet në urën kryesore të Mitrovicës. Sa i përket kësaj, jam i mendimit se akoma nuk janë pjekur kushtet për të ndërmarrë një aksion të tillë”. Ai poashtu shtoj se serbët e veriut të Mitrovicës, manipulohen nga qarqe të caktuara, duke dezinformuar se Plani i Ahtisarit, që ne e shohim si ofertë atraktive për tu zbatuar, synon ta shpërngulë popullatën e atjeshme serbe nga veriu përfundimisht. Kjo, sipas gjeneralit e vështirëson punën e Qeverisë së Kosovës para së gjithash.

Ndërsa në pyetjen drejtuar kryetarit të Komunës, se a i është prezantuar gjeneralit ndonjë kërkesë për realizmin e ndonjë projekti komunal, z. Kilaj shtoj: “ unë e kam njoftuar gjeneralin me nevojat dhe kërkesat që i ka Malisheva, por edhe me të arriturat, e kam njoftuar edhe me ofertën tonë për investitorët e huaj, pasi e dimë se gjenerali së shpejti kthehet në Gjermani dhe mundësitë e tij për të komunikuar me rrethet e biznesit janë shumë të mëdha, andaj e kërkoja nga gjenerali që të bëjë një informim më të madh, dhe të sjellin investitorë këtu”.

Edhe një familje e varfër bëhet me shtëpi



Malishevë, 24 qusht

Falë kontributit të bashkatdhetarëve tanë, edhe një familje e varfër nga Komuna e Malishevës, që nga sot mori çelësat e shtëpisë së tij të re.

Bashkatdhetari Halim Hoti, nga Carralluka, i cili jeton dhe punon në Suedi, ka ndërtuar shtëpinë e qytetarit Daut Begaj në fshatin



Banjë, në vlerë prej rrejt 16 mijë euro.

Kryetari i Komunës z. Isni Kilaj, ka pritur sot në takim vëllaun e Halim Hotit, Musli Hoti, i cili edhe ka shprehur dëshirën që çelësat e shtëpisë së ndërtuar, pronarit, t'ia dorëzoj kryetari i komunës.

“Ju falënderoj shumë sinqerisht për këtë kontribut të jashtëzakonshëm, që keni bërë ndaj qytetarit Daut Begaj, sepse duke e pas parasysh që nevojat janë të mëdha në këtë drejtim, ky kontribut i juaji është një lehtësim i madh për neve si institucion”, kështu u shpreh kryetari Kilaj, në shenjë falënderimi ndaj bashkatdhetarit Hoti. “Unë jam në gjendje për t’ju bashkuar çdo nisme të çdo donatori që shprehë vullnetin për të ndihmuar familjet me kushte të rënda për banim”, vazhdoj më tej z. Kilaj, i cili njëkohësisht e njoftoj z. Hoti se vetëm dy vjetët e fundit, komuna ka ndihmuar me material ndërtimor rreth 60 familje.

Sipas menaxherit të këtij projekti, z. Ahmet Morina, “për ndërtimin e kësaj shtëpie, bashkatdhetarit Halim Hoti, i janë bashkuar edhe donator të tjerë, siç është firma “Standard” , në Banjë, pastaj, Besnik Bytyçi, i cili ka rregulluar instalimin e ujit për këtë familje, dhe Faik Hoti, i cili ka kryer disa nga punimet për ndërtimin e kësaj shtëpie”.

Me këtë rast, Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka ndarë mirënjohje për kontributin e dhënë në ndërtimin e kësaj shtëpie, bashkatdhetarit Halim Hoti.

Malisheva edhe sot i del në ndihmë Dragashit



Malishevë, 27 gusht

Edhe Komuna e Malishevës, Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit i ka dalë në ndihmë Komunës së Dragashit në shuarjen e zjarrit që këto ditë ka kapluar malet e kësaj komune.

Drejtori i Drejtorisë komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim në Malishevë, z. Halit Zogaj, ka bërë të ditur se “edhe sot një ekip i Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të kësaj komune, ka shkuar në Komunën e Dragashit, për ndihmë në shuarjen e zjarrit”. Përveç sot, ekipi i zjarrfikësve nga Malisheva, edhe ditën e premte ka marrë pjesë në shuarjen e zjarrit në malet e Dragashit.

Sa u përket zjarreve, në komunën e Malishevës, vetëm gjatë muajit gusht, kanë ndodhur afërsisht 100 raste zjarresh fushore e malore, por situata ka qenë nën kontroll.

Nga mbledhja e Komitetit për Komunitete

Malishevë, 28 gusht

Komiteti për Komunitete, ka mbajtur sot një takim, në të cilin janë diskutuar disa çështje që ndërlidhen me punën e këtij organi.

Kjo trupë, ka kërkuar që në mbledhjen e ardhshme, të jetë i pranishëm edhe zyrtari për komunitete dhe ai për integritet, për të prezantuar raporte nga puna e tyre.

Ky komitet është i përbërë nga pesë anëtar, kryesisht këshilltar të asamblesë komunale, por edhe nga komuniteti pakicë, ndërsa kryesohet nga Hisni Gashi.



Kolegji “Universum”, ndan pesë bursa për studentë të Komunës së Malishevës

Malishevë, 29 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur sot në takim z. Suat Berisha, Kryetar i Bordit Drejtues të Kolegjit “Universum”, i cili ka dorëzuar një vendim të nënshkruar nga rektori i këtij Kolegji, z. Hajrullah Gorani, përmes së cilit Këshilli Drejtues i këtij institucioni, ka ndarë pesë bursa për studentë të rinj që dëshirojnë të studiojnë në këtë kolegji.



“Këshilli Drejtues i Kolegjit ‘Universum’, ka vendosur të

ndaj pesë bursa të plota për pesë studentë që do të studiojnë në këtë kolegji, konkretisht, njëri nga ta të jetë nga shërbyesit civil, një i familjeve të dëshmorëve, nga veteranët e UCK-së, maturant-familja e të cilit është në asistencë sociale dhe një maturant me sukses të dalluar”, kështu ka bërë të ditur, duke u bazuar edhe në vendim, z. Berisha, në takim me kryetarin Kilaj.

Në anën tjetër Isni Kilaj, kryetar i Komunës së Malishevës ka falënderuar z. Berisha për këtë kontribut dhënë në komunën që ai drejton. “Unë ju falënderoj shumë sinqerisht që keni zgjedhë Komunën e Malishevës, për të ndihmuar në aspektin e arsimit, sidomos ata të cilët kanë nevojë, dëshirë e vullnet, por që nuk kanë mundësi”.

Falënderim ndaj Kolegjit “Universum”, ka adresuar edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Isuf Morina.

Nga mbledhja e tetë e kuvendit të Malishevës

Malishevë, 30 gusht



Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka mbajtur sot mbledhjen e tetë të radhës për këtë vit, e cila kishte parapa tetë pika për rend dite.

Me shumicë votash janë miratuar apo kanë kaluar në kuvend të gjitha pikat e rendit të ditës, të cilat për sot kanë qenë si në vijim: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2012; Shqyrtimi i kërkesës nr. 01/725 datë 06.08.2012, e parashtruar nga shoqata “Pashtriku” me seli në Prizren, për ndarjen e

një lokacioni për ndërtim të një objekti kolektiv; Debat në lidhje me punën e njësisë për menaxhimin e mbeturinave “Ekoregjioni” në Komunën e Malishevës; Shqyrtimi i kërkesës nr. 01/461 datë, 17.04.2012 dhe marrja e vendimit për iniciimin e procedurave për partneritet publiko-privat, përkatësisht dhënien me koncesion të pronës publike (e bartur nga mbledhja e kaluar); Shqyrtimi i kërkesës nr.01/527 datë, 14.05.2012, të kryesisë së fshatit Panorc, për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë për fshatrat Panorc dhe Rud (e bartur nga mbledhja e kaluar); Shqyrtimi kërkesës nr. 02/108 datë, 30.04.2012 nga bashkësia Islame në Malishevë, për ndarjen e një lokacioni për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Goriq, (e bartur nga mbledhja e kaluar); Të ndryshme.

Përgatitur nga Zyra për Informim Publik- Malishevë